



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve

Data: 03.04.2023

Nr: 41

Ora: 11:00

VENDIM

**PËR PRANIMIN PËR SHQYRTIM TË KËRKESËS ANKIMORE NR. 43, DATË 01.04.2023 TË DEPOZITUAR
NGA Z. EDUARD MUHAMET NALLBANI**

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve në mbledhjen e datës 03.04.2023, me pjesëmarrjen e:

Elvis ÇEFA	-	Relator
Elvin LAKO	-	Anëtar
Ilirjan RUSMALI	-	Anëtar
Koli BELE	-	Anëtar
Ledio BRAHO	-	Anëtar

Shqyrtoi çështjen me:

KËRKUES: z. Eduard Muhamet Nallbani, kandidat për Anëtar të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tiranë

OBJEKT: 1. Kundërshtim i vendimit nr. 220, datë 30.03.2023 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve “Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e z. Eduard Muhamet Nallbani si kandidat i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023”.

2. Ndryshimi i vendimit duke vendosur regjistrimin e z. Eduard Muhamet Nallbani, si kandidat për anëtar të Këshillit Bashkiak i propozuar nga zgjedhësit në zonën zgjedhore Bashkia Tiranë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.

BAZË LIGJORE:

Nenet 21/b, 123/1, 126 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të neneve 9 dhe 10, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”

Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur,

VËREN:

Kandidati për anëtar të Këshillit Bashkiak, të Bashkisë Tiranë ka depozituar pranë KQZ-së kërkesën ankimore, e cila në respektim të kritereve të përcaktuara në nenin 127 të Kodit Zgjedhor, është regjistruar në regjistrin e ankimeve zgjedhore, me nr. 43 regj., datë 01.04.2023.

Në mbledhjen e datës 03.04.2023, ora 11:00, pas relatimit të z. Elvis Çefa, u konstatua se kërkesa ankimore nr. 43 i plotësonte elementët e formës të parashikuara në nenin 126, dhe elementet e përcaktuara në nenin 130, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në mbështetje të nenit 17, pika 3, shkronja “a”, të vendimit nr. 03, datë 06.11.2020, të Komisionit Rregullator, “Për mënyrën e funksionimit dhe zhvillimit të seancave të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve”, kërkesa ankimore duhet të kalohet për shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 129, pika 3, shkronja “a”, 130 dhe 131 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, KAS-i

V E N D O S I:

1. Pranimin për shqyrtim të kërkesës nr. 43, datë 01.04.2023 të paraqitur nga z. Eduard Muhamet Nallbani, kandidat për Anëtar të Këshillit Bashkiak, Bashkia Tiranë.
2. Shqyrtimi do të bëhet në datën 04.04.2023 ora 12:00.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Vendimi është i formës së prerë dhe nuk mund të bëhet ankim.

Elvis ÇEFA - **Relator**

Elvin LAKO - **Anëtar**

Ilirjan RUSMALI - **Anëtar**

Koli BELE - **Anëtar**

Ledio BRAHO - **Anëtar**